



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**PROJEKT RREGULLORE**

**PËR NJOHJEN E ADMINISTRUESIT TË FONDEVE TË INVESTIMEVE  
ALTERNATIVE TË LICENCUAR NË NJË VEND ANËTAR TË BE-SË  
DHE REGJISTRIMIN E FONDIT TË INVESTIMEVE ALTERNATIVE  
TË MIRATUAR NË NJË VEND ANËTAR TË BE-SË**

*Miratuar me Vendim Bordi nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_*

**Neni 1**

**Qëllimi i rregullores**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurës, rregullave dhe dokumentacionit për njohjen e administruesit të fondeve të investimeve alternative të licencuar në një vend anëtar të BE-së dhe miratimin e regjistrimit të fondeve të investimeve alternative të miratuar në një vend anëtar të BE-së, që do t'u marketohen dhe shiten investitorëve profesionist dhe të kualifikuar në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 2**

**Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të neneve 66, 132, 135, 136, dhe 240, të ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

**Neni 3**

**Përkufizime**

Termet e përdorura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ato të përcaktuara në ligjin nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

## **Neni 4**

### **Njohja e administruesit të fondeve të investimeve alternative dhe miratimi i regjistrimit të fondit nga Autoriteti**

1. Administruesi i fondeve të investimeve alternative, i licencuar nga një autoritet rregullator i një vendi anëtar të BE-së, për të kryer administrimin dhe marketimin e fondeve të investimeve alternative, mund të marketojë fondet e investimeve alternative në Republikën e Shqipërisë, vetëm pas njohjes nga Autoriteti.
2. Fondi i investimeve alternative i miratuar në një vend anëtar të BE-së dhe i administruar nga një administrues i fondeve të investimeve alternative i licencuar nga një autoritet rregullator i një vendi anëtar të BE-së, mund të marketohet në Republikën e Shqipërisë, vetëm pas miratimit të regjistrimit të tij nga Autoriteti.

## **Neni 5**

### **Agjenti i shitjes**

Administruesi i fondeve të investimeve alternative i njohur, mund të marketojë dhe shesë kuotat e fondeve të investimeve alternative nëpërmjet agjentit të shitjes sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 101, të ligjit nr. 56/2020, dhe në përputhje me rregulloren për regjistrimin e agjentit të shitjes.

## **Neni 6**

### **Kriteret dhe dokumentacioni për njohjen e administruesit të fondeve të investimeve alternative të licencuar në një vend anëtar të BE-së**

1. Kriteret për njohjen e administruesit të fondeve të investimeve alternative të licencuar në një vend anëtar të BE-së janë:
  - a. Të ketë në zbatim marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet autoritetit të vendit të origjinës së administruesit të fondeve të investimeve alternative dhe autoritetit.
  - b. Administruesi i fondeve të investimeve alternative ose autoriteti rregullator i vendit të origjinës së administruesit, i ka përcjellë Autoritetit informacionin se administruesi:
    - i. Është i licencuar për të administruar fonde të investimeve alternative apo për të ofruar shërbime, sipas shkronjave “b” dhe “c”, të pikës 6, të nenit 11, të Ligjit 56/2020;
    - ii. Është objekt i mbikëqyrjes në vendin e vet të origjinës, duke specifikuar ligjin me të cilin mbikëqyret;
    - iii. Ka marrë miratimin e autoritetit rregullator të vendit anëtar të BE-së për kryerjen e veprimtarisë së administrimit dhe marketimit të fondeve të investimeve alternative në Republikën e Shqipërisë, duke i specifikuar këto fonde;
    - iv. Nuk ka masa mbikëqyrëse në fuqi nga autoriteti mbikëqyrës i vendit të origjinës.

2. Administruesi i fondeve të investimeve alternative i licencuar në një vend anëtar të BE-së, njihet nga Autoriteti vetëm pas plotësimit të dokumentacionit të mëposhtëm:
  - a. Një përshkrim të përgjithshëm të qëllimit për të cilin bëhet kërkesa, duke specifikuar arsyet e përzgjedhjes së Shqipërisë, si vend për të marketuar fondin e investimeve alternative;
  - b. Vendimin e organit drejtues të saj për të marketuar fondet e investimeve alternative në Republikën e Shqipërisë;
  - c. Listën e fondeve të investimeve alternative që do të marketojë në Republikën e Shqipërisë;
  - d. Informacion për mënyrën e marketimit të FIA në Republikën e Shqipërisë;
  - e. Listën me emrat e personave kyç dhe personelit kyç të administruesit të fondeve të investimeve alternative;
  - f. Vendndodhjen e selisë qendrore së saj;
  - g. Dokumentin e angazhimit dhe të dhëna mbi agjentin e shitjes të propozuar.

## **Neni 7**

### **Kriteret dhe dokumentacioni për miratimin e regjistrimit të fondeve të investimeve alternative të miratuar në një vend anëtar të BE-së**

1. Me njohjen e administruesit të fondeve të investimeve alternative, me qëllim miratimin e regjistrimit të fondit të investimeve alternative nga Autoriteti duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
  - a. të ketë marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet autoritetit rregullator të vendit të origjinës së fondit të investimeve alternative dhe autoritetit, si dhe të vendit të origjinës së administruesit të fondeve të investimeve alternative dhe autoritetit.
  - b. administruesi i fondeve të investimeve alternative të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të kryer pagesat e investitorëve në Republikën e Shqipërisë, për të shlyer pjesëmarrjet dhe për vënien në dispozicion të informacioneve që administruesi i fondeve të investimeve alternative duhet të hartojë, sipas rregullave të vendit të tij të origjinës;
  - c. vendi i origjinës i fondit të investimeve alternative të mos jetë i përfshirë në listën e vendeve jobashkëpunuese nga Task Forca e Veprimit Financiar për Pastrimin e Parave (FATF-ML);
  - d. fondi i investimeve alternative dhe administruesi i fondit të investimeve alternative të jenë objekt mbikëqyrjeje në vendin e origjinës dhe përmbushin kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë tregtare në vendin e origjinës,
  - e. informacion, nëse ka pasur ngjarje materiale gjatë vitit paraardhës, të cilat do të ndikonin në performancën e fondit.
2. Me qëllim miratimin e regjistrimit të fondeve të investimeve alternative, administruesi i fondit duhet të depozitojë informacionin e mëposhtëm:
  - a. Prospektin dhe rregullat e fondit, në gjuhën shqipe, të cilat duhet të parashikojnë qartë se fondi është një fond investimi alternativ vetëm për klientë profesionistë dhe të kualifikuar, aksionet ose kuotat e së cilës do të marketohen dhe shiten në Republikën e Shqipërisë;
  - b. Shtojcën e prospektit me informacionin në lidhje me mënyrën e marketimit dhe shitjes së fondit

- të investimeve alternative në Republikën e Shqipërisë;
- c. Dokumentin e angazhimit midis administruesit të fondit të investimeve alternative dhe agjentit të shitjes në përputhje me kërkesat e nenit 102 të ligjit nr. 56/2020, i cili regjistrohet nga Autoriteti për të marketuar fondin e investimeve alternative;
  - d. Programin e veprimtarisë, ku identifikohet fondi i investimeve alternative dhe vendi në të cilin është vendosur fondi i investimeve alternative;
  - e. Informacione për fondin e investimeve alternative, që u janë vënë në dispozicion investitorëve të fondit të investimeve alternative, përfshirë informacionet e parashikuara në nenin 126 të ligjit 56/2020;
  - f. Pasqyrën e masave, që kanë për qëllim të parandalojnë që fondi i investimeve alternative t'u ofrohet klientëve joprofionistë dhe jo të kualifikuar edhe në rastet kur oferta kryhet nëpërmjet një agjenti.
  - g. marrëveshjen me depozitarin e licencuar të fondit të investimeve alternative dhe dokumente që vërtetojnë statusin e licencuar dhe të pavarur të depozitarit;
  - h. Raportin vjetor më të fundit të fondit të investimeve alternative;
  - i. Programet dhe materialet e trajnimit që do të ndiqen nga stafi i agjentit të regjistruar, i cili do të marketojë dhe shesë aksionet ose kuotat e fondit të investimeve alternative në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi;
  - j. Një përshkrim të trajtimit tatimor të mbajtësve të kuotave në Republikën e Shqipërisë;
  - k. Procedurën për shitjen dhe procedurën në lidhje me trajtimin e ankesave për investitorët e Republikës së Shqipërisë; dhe
  - l. Nëse fondi i investimeve alternative është një sipërmarrje furnizuese, informacion për fondin e investimeve alternative kryesor, përfshirë se ku është miratuar FIA kryesore, si dhe prospektin e saj.

## **Neni 8**

### **Transparenca**

1. Prospekti që do i vihet në dispozicion investitorëve në Republikën e Shqipërisë, duhet të përmbajë një Shtojcë me informacionin lidhur me mënyrën e marketimit dhe shitjes së aksioneve ose kuotave të fondit të investimeve alternative të miratuar në një vend të BE-së në Republikën e Shqipërisë.
2. Prospekti që u vihet në dispozicion investitorëve, hartohet në gjuhën shqipe dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të agjentit të regjistruar, nëpërmjet të cilit administruesi i njohur mund të marketojë dhe të shesë kuotat e fondit të investimeve alternative.

## **Neni 9**

### **Shqyrtimi i kërkesës për njohjen e administruesit të fondeve të investimeve alternative dhe miratimin e regjistrimit të fondit të investimeve alternative**

1. Autoriteti, gjatë procesit të njohjes së administruesit të fondeve të investimeve alternative të miratuar në një vend anëtar të BE-së, dhe miratimit të regjistrimit të fondit të investimeve alternative, të miratuar në një vend anëtar të BE-së, merr në konsideratë si më poshtë:

- a. Informacionin e nevojshëm të përcaktuar në ligj dhe në këtë rregullore si dhe informacionet shtesë të kërkuara;
  - b. Ekzistencën e një marrëveshjeje me objekt bashkëpunimin e duhur mbikëqyrës midis autoritetit rregullator të vendit të BE-së të administruesit të fondeve të investimeve alternative të miratuar në një vend anëtar të BE-së, dhe Autoritetit;
  - c. Masat e nevojshme për pagesën në Republikën e Shqipërisë të investitorëve për shlyerjen e aksioneve ose kuotave të fondeve të investimeve alternative dhe vënien në dispozicion të informacionit për investitorët që shoqëriaharton dhe përgatit, sipas rregullave të vendit të saj të origjinës të ndërrmarra nga Administruesi i fondeve të investimeve alternative të miratuar në një vend anëtar të BE-së; ;
  - d. Përputhshmërinë e kërkesës me dispozitat e marrëveshjes së bashkëpunimit që Autoriteti ka lidhur me Autoritetin rregullator të vendit të BE-së.
2. Autoriteti gjatë periudhës së shqyrtimit, mund të kërkojë çdo informacion shtesë të mëtejshëm. që është i nevojshëm për të gjykuar mbi plotësimin e kriterëve nga subjekti kërkuar. Kërkesa për plotësim dokumentacioni dhe/ose plotësimi i përmbajtjes së dokumenteve të depozituara, i komunikohet subjektit me shkrim ose në mënyrë elektronike.

## **Neni 10**

### **Afati i trajtimit të kërkesave, regjistrimi dhe njoftimi nga Autoriteti**

1. Autoriteti, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës, shqyrton kërkesën dhe listën e dokumenteve të depozituara për njohje sipas ligjit nr. 56/2020 dhe kësaj rregulloreje.
2. Autoriteti, nëse vëren se kërkesa e depozituar nuk përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar, i kërkon subjektit me shkrim ose në mënyrë elektronike, që brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune të plotësojë kërkesën duke specifikuar dokumentet që mungojnë.
3. Nëse subjekti me kërkesë të argumentuar nuk është në gjendje të paraqesë ndonjë nga dokumentet brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune, afati shtyhet edhe me 30 (tridhjetë) ditë pune të tjera. Nëse subjekti kërkuar nuk depoziton dokumentet e kërkuara brenda afatit të përcaktuar në këtë nen, Autoriteti nuk merr në shqyrtim kërkesën e paplotë dhe njofton me shkrim ose në mënyrë elektronike subjektin kërkuar.
4. Autoriteti brenda 1 (një) muaji nga marrja e informacionit të plotë për njohjen e administruesit të fondeve të investimeve alternative të miratuar në një vend anëtar të BE-së, dhe/ose regjistrimin e fondit të investimeve alternative, të miratuar në një vend anëtar të BE-së, merr vendim për njohjen/regjistrimin ose refuzimin e njohjes/regjistrimit dhe njofton autoritetin rregullator të vendit të BE-së si dhe subjektin mbi vendimin e tij.
5. Autoriteti regjistron në regjistrin përkatës çdo administrues të fondeve të investimeve alternative të miratuar në një vend anëtar të BE-së për të marketuar dhe shitur aksione ose kuota të fondeve të investimeve alternative në Republikën e Shqipërisë, dhe çdo fond të investimeve alternative të miratuar në një vend anëtar të BE-së për të cilën është dhënë njohja/regjistrimi. Regjistri i subjekteve publikohet në faqen e internetit të Autoritetit.

## **Neni 11**

### **Ndërprerja e aktivitetit të administruesit të fondeve të investimeve alternative në Republikën e Shqipërisë**

1. Nëse administruesi i fondeve të investimeve alternative i licencuar në një vend anëtar të BE-së vendos të ndërpresë marketimin dhe shitjen e aksioneve ose kuotave për investitorët në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet të njoftojë menjëherë dhe pa vonesa Autoritetin.
2. Autoriteti me marrjen e njoftimit çregjistron administruesin e fondeve të investimeve alternative të licencuar në një vendanëtar të BE-së dhe të njohur.
3. Administruesi i fondeve të investimeve alternative i cili ndërpret marketimin dhe shitjen e aksioneve ose kuotave të fondeve të investimeve alternative të miratuara në një vend anëtar të BE-së, duhet të njoftojë investitorët në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet agjentit të regjistruar të shitjes. Njoftimi publikohet në gazetata me qarkullim të përditshëm dhe në faqen zyrtare të internetit të administruesit të fondeve të investimeve alternative dhe agjentit të regjistruar të shitjes.

## **Neni 12**

### **Detyrimi për informacion dhe raportimi në Autoritet**

1. Administruesi i fondeve të investimeve alternative i licencuar në një vend anëtar të BE-së, pas njohjes i mundëson Autoritetit çdo informacion që kërkohet për çështjet e lidhura me veprimtarinë e subjekteve të licencuara/njohura.
2. Administruesi i fondeve të investimeve alternative i njohur i mundëson menjëherë Autoritetit çdo informacion që zotëron, nëse është në dijeni apo ka arsye të besojë se:
3. Informacioni është i rëndësishëm për ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse dhe rregullatore të autoritetit lidhur me subjektet e licencuara/njohura, sipas ligjit nr. 56/2020 dhe kësaj rregullore. Mosdhënia e informacionit çon në keqinformimin dhe/ose mashtrimin e Autoritetit përçështje me rëndësi në ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse dhe rregullatore të tij lidhur me subjektet e licencuara/njohura, sipas ligjit nr. 56/2020 dhe kësaj rregulloreje.
4. Administruesi i fondeve të investimeve alternative i njohur, informon menjëherë Autoritetin për çdo çështje që ka dijeni ose që ka arsye të besojë sa më poshtë:
  - a. Gjendja ekzistuese ose e ndryshuar e aktivitetit mund të rrezikojë të drejtat e mbajtësvetë aksioneve ose kuotave të fondeve të investimeve alternative të administruara nga administruesi i fondeve;
  - b. Çdo veprimtari kriminale që lidhet me ofrimin e shërbimeve të tyre, përfshirë veprimtaritë e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
5. Administruesi i fondeve i njohur, informon Autoritetin nëse ka ndryshime lidhur me:
  - a. Emërimin dhe shkarkimin e personave kyç dhe personelit kyç;
  - b. Fillimin ose ndërprerjen e planifikuar të veprimtarive;
  - c. Marketimin; dhe
  - d. Kontratat e lidhura me agjentët e shitjeve të regjistruar.

## **Neni 13**

### **Revokimi i vendimit të njohjes të administruesit të fondeve të investimeve alternative të licencuar në një vend anëtar të BE-së, dhe/ose regjistrimit të fondit të investimeve alternative, të miratuar në një vend anëtar të BE-së**

Autoriteti mund të revokojë vendimin e njohjes dhe regjistrimit nëse:

- a. Nuk përmbushen më kërkesat e gërmave ç), d) ose dh), të nenit 96, pikës 4, të ligjit nr. 56/2020;
- b. Autoriteti i vendit të BE-së, merr masa për revokimin e licencës së administruesit të fondeve të investimeve alternative të miratuar në një vend anëtar të BE-së, dhe/ose regjistrimin e fondit të investimeve alternative, të miratuar në një vend anëtar të BE-së;
- c. Janë shkelur kriteret e përcaktuara për njohjen dhe regjistrimin sipas ligjit nr. 56/2020 dhe kësaj rregullore;
- d. Nuk përmbushen kërkesat që investitorëve në Republikën e Shqipërisë, t'i vihet në dispozicion dokumentacioni në gjuhën shqipe;
- e. Shkelen kërkesat rregullatore të Autoritetit për transparencë kundrejt investitorëve.

## **Neni 14**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.